



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË**  
**KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

Nr. 1259/4 prot.

Datë 13/07/2023

**V E N D I M**  
**Nr. 611/2023**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 13/07/2023 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Haxhi Shahu*” PF në procedurën e prokurimit “*E hapur, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-66184-04-14-2023, me objekt: “*Shërbim akomodim personeli*”, me fond limit 39.592.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier.

Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për skualifikimin e ofertës të paraqitur nga operatori ekonomik “*Eral*” SHPK, në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Ankimues:**

Operatori ekonomik “*Haxhi Shahu*” PF  
Adresa: Lagjja “*Mbrostar*”, Ura “*Rruga Fier-Tiranë*” Kilometri i tretë, Fier.

Operatori ekonomik “*Eral*” SHPK  
Adresa: Rruga “*Jakov Xoxa*”, Fier.

**Autoriteti Kontraktor:** Spitali Rajonal Memorial Fier  
*Adresa: Qender, Afrimi i Ri, Rruga "Daullas Grecalli" Nr 17, Daullas, Fier.*

**Baza Ligjore:** Ligji nr. 162/2020 "*Për Prokurimin Publik*", Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 "*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*", Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 "*Për miratimin e rregullave "Për Organizimin dhe Funkcionimin e Komisionit të Prokurimit Publik"*", Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 "*Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19*".

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim e pretendimet e ankimuesve, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

## **V ë r e n:**

### **I**

#### *Vlerësimi paraprak*

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e lartë monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*" dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatorët ekonomikë kanë *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohen për të paraqitur ankesë në lidhje me të. Gjithashtu, KPP konstatoi, se ankesat e operatorëve ekonomikë janë paraqitur për të njëjtën procedurë prokurimi, ndaj edhe ankimet e tyre duhet të bashkohen e të shqyrtohen në një gjykim të vetëm.

I.3. Operatorët ekonomikë ankimues kanë paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 "*Për prokurimin publik*".

I.4. Ankimuesit kanë respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

### **II**

## *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 18.04.2023 është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “E hapur, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-66184-04-14-2023, me objekt: “Shërbim akomodim personeli”, me fond limit 39.592.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier.

II.2. Më datën 18.05.2023 autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi.

II.3. Në datën 25.05.2023 autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

1. “eRAL” SHPK	35.952.000 lekë	skualifikuar
2. “Haxhi Shahu” PF	37.236.000 lekë	skualifikuar

II.4. Në datën 25.05.2023 operatori ekonomik “Eral” SHPK është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“1. Ju nuk keni paraqitur licensën e lëshuar nga organi kompetent përkatës për ushtrimin e aktivitetit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.89, datë 01.03.1993 “Për dhënien e licensave për ushtrimin e veprimtarisë turistike”, si dhe në Udëhezimin e përbashkët nr.1, datë 19.05.2003 “Mbi licensimin dhe kontrollin e ushtrimit ëte veprimtarisë turistike” pika 1 e tij.

2. Dokumenti “Certifikate ISO 9001-2015” rezulton fotokopje e panoterizuar.

3. Në deklaratën mbi përmbushjen e specifikimeve teknike, keni deklaruar se struktura e hotelit është unike dhe çdo shërbim kryhet brenda strukturës gjë e cila nuk jep siguri maksimale për personelin turk bazuar në Vendimin nr. 58, datë 26.1.2022 “Për miratimin e protokollit ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Qeverisë së Republikës së Turqisë, për funksionimin e përbashkët të Spitalit Rajonal “Memorial” në Fier, gjatë fazës kalimtare “. Kjo gjë vërtetohet dhe nga faturat tatimore të paraqitura nga ana Juaj ku vërehet se në ambientet e hotelit jepen ambiente me qera për zyra, konferenca etj.”.

II.5. Në datën 25.05.2023 operatori ekonomik “Haxh Shahu” PF është njoftuar elektronikisht për klasifikimin e ofertave, si dhe skualifikimin e tij në këtë procedurë prokurimi me argumentet si më poshtë vijon:

“1. Ju nuk keni paraqitur licensën e lëshuar nga organi kompetent përkatës për ushtrimin e aktivitetit, bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr.89, datë 01.03.1993 “Për dhënien e licensave për ushtrimin e veprimtarisë tursitike”, si dhe në Udhëzimin e përbashkët nr.1, datë 19.05.2003 “Mbi licensimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë turistike” pika 1 e tij.

2. Për shërbime të ngjashme të mëparshme keni paraqitur vërtetim mbi përmbushjen e një kontrate, por pa u vërtetuar ky fakt me kontratën dhe/ose faturat përkateëse për vitin 2021.”.

II.6. Në datën 30.05.2023, në Sistemin e Prokurimit Elektronik, është publikuar Njoftimi i Anulimit të procedurës së mësipërme të prokurimit.

II.7. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 05.06.2023 operatori ekonomik “Haxhi Shahu” PF, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe në datë 01.06.2023 ka paraqitur ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-66184-04-14-2023, me objekt: “Shërbim akomodim personeli”, me fond limit 39.592.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier.

II.8. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1259/2 prot., datë 02.06.2023 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Haxhi Shahu” PF kundërshton me anë të ankesës me nr. 1259 protokollit, datë 01.06.2023.

II.9. Me shkresën nr. 778/4 prot, datë 08.06.2023 me objekt: “Dërgim vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (KSHA)” protokolluar me tonën me nr. 1259/3 prot, datë 12.06.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Haxhi Shahu” PF për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.10. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 05.06.2023 operatori ekonomik “Eral” SHPK, ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe pranë Komisionit të Prokurimit Publik për procedurën e prokurimit “E hapur, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara”, me Nr. REF-66184-04-14-2023, me objekt: “Shërbim akomodim personeli”, me fond limit 39.592.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier.

II.11. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Komisioni i Prokurimit Publik me marrjen e ankesës, e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1280/2 prot., datë 06.06.2023 janë publikuar arsyet e skualifikimit që operatori ekonomik ankimues “Eral” SHPK kundërshton me anë të ankesës me nr. 1280 protokoli, datë 05.06.2023.

II.12. Me shkresën nr. 773/4 prot, datë 08.06.2023 me objekt: “Dërgim vendimi i Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës (KSHA)” protokolluar me tonën me nr. 1280/3 prot, datë 12.06.2023 është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, informacioni dhe vendimi i autoritetit kontraktor lidhur me trajtimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik “Eral” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, në të cilën është vendosur mospranimi i ankesës.

II.13. Me shkresën nr. 12 prot, datë 16.06.2023 me objekt: “Në vijim të shqyrtimit të ankesës nr. 1280/2023, datë 05.06.2023” protokolluar me tonën me nr. 1280/4 prot, datë 16.06.2023, është dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik informacioni i operatorit ekonomik ankimues “Eral” SHPK lidhur me shkresën nr. 3616/1 prot, datë 14.06.2023 të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, ku citohet si më poshtë vijon:

*“Në vijim të shkresës tuaj, protokolluar pranë Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit me nr. 3616 prot., datë 06.06.2023, me lëndë “Kërkesë”, ju bëjmë me dije se:*

*Ministria e Turizmit dhe Mjedisit është institucioni kompetent, që sipas Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016 “Për miratimin e rregullores për kushtet, kriteret, tarifat, afatet dhe procedurën për klasifikimin e strukturave akomoduese”, i ndryshuar, ndjek dhe trajton procedurën për pajisje me “Certifikatë kategorizimi”, dokument i lëshuar nga komisioni i standardizimit të veprimtarive turistike për klasifikimin e strukturës akomoduese.*

*Bazuar në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 730, datë 20.10.2016, çdo sipërmarrës turistik, që ushtron veprimtarinë si strukturë akomoduese, duhet të pajiset me certifikatë kategorizimi për ushtrimin e këtij aktiviteti.*

*Për interesin tuaj, ju bëjmë me dije se kategoritë për strukturat akomoduese janë si vijon:*

- a) “Bujtinë”;
- b) “Fjetinë” (Hostel);
- c) “Kamping”; ç) “Hotel”;
- d) “Motel”; dh) \*Resort”;
- e) “Qendër kurative”;

ë) “Fjetje dhe mëngjes” (B&B). “.

II.14. Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e shqyrtimit administrativ, si dhe bazuar në informacionin e Autoritetit Kontraktor, u konstatua se nuk ka pasur pretendime nga subjekte të interesuara, në përputhje me nenin 113 të ligjit Nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

### III

#### Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

#### Arsyeton

III.1. Para shqyrtimit në themel të pretendimeve të operatorëve ekonomikë ankimues, në zbatim të nenit 29, pika 2 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, në të cilin parashikohet se: “1. Komisioni shqyrton ankesën brenda objektit dhe shkaqeve të parashtruara në ankesë. 2. Përjashtimisht, kur ka lidhje midis objektit të ankesës dhe vendimeve apo veprimeve të tjera të autoritetit kontraktor gjatë procedurës së prokurimit, Komisioni vendos edhe për ligjshmërinë e tyre”, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon të ndalet fillimisht në ligjshmërinë e veprimeve të autoritetit kontraktor, për sa kohë që objekti i ankesës ka lidhje me kriteret kualifikuese për të cilat KPP gjykon se nuk janë hartuar në përputhje me përcaktimet në LPP si vijon:

III.1.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Haxhi Shahu” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsye se: “... Në njoftimin që na ka ardhur në sistem për skualifikim në procedurën e konkurimit na njoftohet për mungesë të certifikatës origjinale të kategorizimit të hotelit (që është e hedhur në sistem me datën 19,04,2023 ora 15,41 po e rifusim të ky ankimim në të njëjtën kohë autoriteti kontraktues është duke bashkëpunuar me ne prej njëje periudhe 2 vjeçare, duke e njohur automatikisht këtë Certifikatë) si dhe faturat e hedhura në sistem plotësojnë kushtet teknike, por vërtetimi plotësimi të kërkesës për përvojë të mëparshme është i vitit të kaluar që kushti thotë vërtetim për kontratë të mëparshme me objekt të njëjtë ose fatura tatimore (është futur në sistem vërtetim për plotësim kontrate me objekt të njëjtë si dhe fatura tatimore përkatëse për një shumë dyfish nga ajo e kërkuar në kushtet e prokurimit në fjalë) të dy këto dokumente janë të lëshuara nga autoriteti kontraktues si dhe faturat janë po të të njëjtit institucion me objekt “Akomodim

hotelerie” për ekipin e mjekëve turq të Spitalit Memorial Fier, po ju bashkangjisim edhe faturat e viteve më parë për tablo më të plotë të Komisionit të Prokurimit Publik.

Të dy kushtet janë të plotësuara dhe dokumentet të bashkëngjitura në ofertën tonë pranë autoritetit kontraktues. Për kushtin e parë është pjesë e ofertës sonë si më poshtë: Certifikata e kategorizimit e lëshuar nga Ministria e Turizmit dhe certifikatat e regjistrimit pranë organave tatimore, si dhe vërtetimet përkatëse për shlyerje detyrimesh pagesat e sigurimeve shëndetsore dhe shoqërore, xhiroja e kryer për 3 vitet e fundit dhe vërtetim për aktivitet aktiv, certifikatë e strukturës akomoduese si hotel nga Ministria e Turizmit dhe e certifikuar në Booking dhe TripAdvisor me 4 yje, certifikata e Miratimit Higjeno-sanitar si dhe certifikimet përkatëse të AKU, kontrolli periodik i librezave shëndetsore, kontrolli periodik i ujit, certifikata e disinfektimit, certifikata e enëve në presion certifikata e kontrollit periodik të ashensorit, certifikata periodike e cilësisë ISO 9001-2015 si dhe vërtetim për plotësim të kontratave të mëparshëm me objekt të njëjtë si dhe fatura tatimore me të njëjtin objekt si procedura e konkurimit (shërbim hotelerie). Për sa më sipër mund të konstatoj se në mënyrë të pavullnetshme mund tju ken’ë kaluar pa vënë re këto dokumente, por në të gjitha rastet këto dokumente janë të pranuar dhe deklaruara si nga ana ime edhe nga ana e autoritetit kontraktues pranë organeve tatimore për periudhën mbi dy vitet e fundit.”, si dhe lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Eral” SHPK mbi kundërshtimin e skualifikimit të ofertës së tij nga procedura prokurimit objekt-shqyrtimi me arsyet se: “... Skualifikimi i shoqërisë sonë bien ndesh argumentimin e dhënë për kriterin 2.1.1 të autoritetit kontraktor, ç’ka do të thotë se vendimi për skualifikim e ofertës sonë ekonomike pëer mosplotësimin e këtij kriteri është i pabazuar dhe për rrjedhojë i kundërligjshëm, ardhur si pasojë e mos shqyrtimit të dokumentacionit tonë dhe interpretimit të gabuar të ligjit për prokurimin publik nga ana e komisionit të vlerësimit të procedurës së prokurimit. Në interpretim të kriterit të vendosur nga autoriteti kontraktor kërkohet paraqitja e dokumentacionit: Licencën përkatëse të lëshuar nga Organi Kompetent bazuar në legjislacionin e pasqyruar dhe në procesverbalin mbi argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike. Nga ana e autoritetit kontraktor nuk është kërkuar dokumentacion konkret se çfarë license kërkohet, pika e licensës apo institucioni/organi kompetent për licensimin e subjektit. Autoriteti kontraktues është organi përgjegjës për prokurimin e fondeve publike, në përputhje me dispozitat ligjore e nënligjore në fuqi. Në këtë kuadër, përcaktimi i kriterëve të veçanta për kualifikim është lënë nën përgjegjësinë e autoritetit kontraktor, gjithnjë në përputhje e përpjesëtim me objektin e natyrën kontratës objekt prokurimi, si dhe aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi që lidhen në mënyrë të drejtëpërdrejtë me kriteret e vendosura në dokumentat e tenderit.

Vlen të theksohet se, kriteret e kualifikimit, nga autoriteti kontraktor duhet të përcaktohen të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, volumin dhe objektin e kontratës, objekt prokurimi me qëllim që të kryhet një vlerësim i drejtë, duke mos i dëmtuar pjesëmarrësit në këtë procedure. Shoqëria jonë për plotësimin e këtij kriteri i kemi paraqitur në SPE dokumentacionin si më poshtë;

Ekstrakt i rregjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar” ku në objektin e aktivitetit pasqyrohet; Posedim administrim hotele bare, ... .

*Gjithashtu kemi dorëzuar në sistemin elektronik dokumentacionin si më poshtë:*

*Certifikatë kategorizimi 'Strukturë akomoduese'ERAL shpk për ushtrimin e veprimtarisë si strukturë akomoduese: Kategoria "Hotel". Ky autoritet ka vlerësuar me dy standarte duke na skualifikuar në procedurën objekt ankimi dhe duke e vlerësuar ofertën tonë të vlefshme në procedurën e mëparshme me nr. REF-25878-04-20-2022 për të njëjtin kriteret, në kushtet kur kuadri ligjore brenda këtyre dy viteve nuk ka ndryshuar për sa i përket licensimit/certifikimit të operatoreve turistike mbi shërbimet akomoduese/hoteleri.*

*Shoqëria jonë ashton aktivitet hoteleri që prej 01.07.1996 që shifet qartësisht se ka objektin e veprimtarisë dhe disponon dokumentacionit ligjor mbi këtë veprimtari (QKB dhe certifikatë për kategorizim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (ministrija përgjegjëse)).*

*Nga viti i krijimit deri sot nga organet ligjzbatuese dhe kontrolluese në fushën ku ne ushtojmë aktivitet nuk na është kërkuar një licensë e tillë dhe aq me tepër të kemi marr ndonjë shkëlqje administrative për mungesë dokumentacioni ligjor në fushën ku ne ushtrojmë aktivitet. ... Sa më sipër, në bazë të dokumentacionit të dorëzuar në SPE, Ekstrakt i regjistrimit tregtar për të dhënat e subjektit dhe certifikatë për kategorizim nga Ministria e Turizmit dhe Mjedisit (Ministria përgjegjëse), vërtetohet se plotësojmë kriterin jemi në kushtet e përmbushjes së kërkesave në kriterin e veçante të kualifikimit të përcaktuar në dokumentet e procedurës së prokurimit objekt-ankimi, licencën përkatëse të lëshuar nga organi kompetent referuar dokumentacionit të dorëzuar në sistemin e prokurimeve elektronike. Oferta jonë është në përputhje me ligjin nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", nenin 41, pika 4, gërma a, të VKM nr.255, datë 19.05.2021, "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", si dhe në mbështetje të ligjit Nr. 93/2015 "Për turizmin"; Vendimit të Këshillit të Ministrave nr.89, datë 1.3.1993 "Për dhënien e licencave për ushtrimin e veprimtarive turistike", të Udhëzimit të përbashkët Nr.1, datë 19.5.2003 "Mbi licensimin dhe kontrollin e ushtrimit të veprimtarisë turistike" pika 1 e tij, si dhe të Urdhërit të Ministrisë të Turizmit dhe Mjedisit nr.267, datë 24.07.2019 "Mbi miratimin e rregullores për mënyrën, kriteret dhe procedurat e kategorizimit të strukturave akomoduese", i ndryshuar, neni 8 i saj ( të përcaktuara këto dhe në procesverbali-tipi i kontratës-shërbime 'Për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim"për argumentimin e kriterit 2.1.1 i publikuar në SPE). ... Sa më sipër, pretendimi i autoriteti kontraktor nuk qëndron dhe oferta jonë duhet të kualifikohet për këtë arsye skualifikimi.", Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.1.2. Në shtojcën 8 "KRITERET E PËRGJITHSHME TË PËRZGJEDHJES/ KUALIFIKIMIT" pika 2.1.1 "Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë" të dokumenteve të modifikuara të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka përcaktuar kriterin kualifikues si më poshtë:

**"2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:**

**Kriter 2.1.1 :** Licencën përkatëse të lëshuar nga Organi kompetent. "



III.1.3. Neni 2 “Qëllimi i ligjit” të Ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” parashikohet se:

“Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.”.

III.1.4. Neni 3 “Parime të përgjithshme” të Ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

- “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale.
- 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar.
- 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.” .

III.1.5. Neni 21 “Autoriteti ose enti kontraktor” të Ligjit nr.162/2021 “Për prokurimin publik” përcaktohet se:

- “1. Autoriteti ose enti kontraktor është përgjegjës për prokurimin në përputhje me dispozitat e këtij ligji dhe të akteve nënligjore të nxjerra në zbatim të tij, duke garantuar respektimin e parimeve të trajtimit të barabartë, transparencës, konkurrencës dhe mosdiskriminimit, të parashikuara në këtë ligj. Në kuptim të kësaj pike, autoriteti ose enti kontraktor ka detyrimin të mirëplanifikojë në cilësi dhe në kohë fondet publike e nevojat e tij dhe të prokurojë e të zbatojë kontratën në përputhje me legjislacionin në fuqi.”.

III.1.6. Në lidhje me kundërshtimet e mësipërme të operatorëve ekonomikë ankimes, KPP vëren se autoriteti kontraktor ka hartuar kriterin e kualifikimit të sipërcituar në kushtet e paqartësisë dhe konfuzionit sa i takon llojit të licensës për ushtrimin e aktivitetit të hotelierisë dhe organit kompetent që e lëshon këtë në procedurën e prokurimit objekt ankimi. Konkretisht autoriteti kontraktor në kriterin e vecantë të kualifikimit ka kërkuar që operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë licensën përkatëse të lëshuar nga organi kompetent për ushtrimin e veprimtarisë së

hotelerisë. KPP gjykon se në kushtet kur autoriteti kontraktor ka kërkuar që operatorët ekonomikë ofertues të paraqesin licensën përkatëse të lëshuar nga organi kompetent ka lënë të papërcaktuar dhe evazive llojin e licensës dhe organin kompetent i cili e lëshon këtë license, duke shkaktuar konfuzion në rradhët e operatorëve ekonomikë dhe duke lënë hapësirë për vlerësim subjektiv në procesin e vlerësimit të ofertave. KPP gjykon se autoriteti kontraktor në rastin konkret duhet të kishte përcaktuar në mënyrë të qartë llojin e licensës dhe organin kompetent i cili e lëshon këtë license në mënyrë që ofertuesit të ishin tërësisht të qartë mbi mënyrën e përmbushjes së kriterit kualifikues të përcaktuar në pikën 2.1.1 “*Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë*” të Shtojcës 8 të dokumentave të tenderit. Pra në asnjë moment autoriteti kontraktor nuk ka përcaktuar llojin e licensës të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së hotelerisë objekt-prokurimi dhe organin shtetëror që e lëshon këtë licensë të kërkuara në kriterin e veçantë të kualifikimit, duke mos përcaktuar dokumentacionin konkret me anë të të cilit do provohet përmbushja e këtij kriteri kualifikues të sipërpërmendur. KPP gjykon se kriteret e kualifikimit duhet të jenë në përpjesëtim dhe të lidhura ngushtë me aftësinë zbatuese, natyrën dhe vlerën e kontratës. Por në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të përcaktojë dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët ekonomikë për përmbushjen e këtyre kriterëve.

III.1.8. Sa më sipër, KPP gjykon se në rastin konkret kriteri i veçantë i kualifikimit i hartuar nga autoriteti kontraktor ka shkaktuar konfuzion tek operatorët ekonomikë sa i takon llojit të licensës të nevojshme për ushtrimin e veprimtarisë së hotelerisë objekt-prokurimi dhe organin shtetëror që e lëshon këtë licensë të kërkuar, si dhe mënyrës së provueshmërisë së disponimit të kësaj license në procedurën e prokurimit objekt-ankimi. Hartimi i kriterëve kualifikues në mënyrë jo të plotë dhe të saktë shkakton paqartësi të cilat ndikojnë jo vetëm tek operatorët ekonomikë gjatë përgatitjes së ofertave të tyre, por edhe vështirësojnë punën e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave të cilët do të detyrohen të vlerësojnë procedurën mbi kriteret e paqarta, konfuze dhe që shkaktojnë pabarazi në vlerësimin e ofertuesve. Në këtë kuptim, KPP gjykon se kërkesat kualifikuese/specifikimet teknike të procedurës së prokurimit duhet të përcaktohen, të qarta, të sakta dhe në përputhje me legjislacionin në fuqi, me qëllim kryerjen e një vlerësimi të drejtë dhe jo diskriminues, duke mos penguar pjesëmarrjen në një procedurë prokurimi. Mospërcaktimi i saktë i kriterit si në rastin konkret, shkel parimin e mosdiskriminimit dhe trajtimit të barabartë të operatorëve ekonomikë, nxitjes së konkurrencës dhe pjesëmarrjes në procedurën e prokurimit. Në këto kushte KPP gjykon se paqartësitë e krijuara në këtë rast përbëjnë shkak për anulimin e procedurës së prokurimit objekt ankimi.

Sa më sipër analizuar, Komisioni i Prokurimit Publik bazuar në nenin 118, pika 2, gërma “b” të Ligjit nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”, ku përcaktohet se: “*Përpara lidhjes së kontratës, Komisioni i Prokurimit Publik ka të drejtë: të pranojë ankesën dhe të urdhërojë autoritetin ose entin kontraktor të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin; nenin 98, pika 1, gërma “d” të këtij ligji.*”, ku thuhet shprehimisht:

*“Autoriteti ose enti kontraktor anulon procedurën e prokurimit në rastet kur Komisioni i Prokurimit Publik vendos anulimin sipas parashikimeve në këtë ligj”, si dhe në nenin 45, pika 1 gërma “b” të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, ku parashikohet se: “[...] Komisioni i Prokurimit Publik në kuadër të veprimtarisë së shqyrtimit të ankesave para lidhjes së kontratës procedon me: b) Vendim për pranimin e ankesës dhe urdhërimin e autoritetit/entit kontraktor, që të anulojë plotësisht ose pjesërisht një veprim ose vendim, të nxjerrë në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” [...], gjykon se për shkak të konfuzionit të krijuar procedura e prokurimit duhet të anulohet nga autoriteti kontraktor dhe në rishpalljen e saj autoriteti duhet të mbajë në konsideratë parashikimet e këtij vendimi.*

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “*Haxhi Shahu*” PF në procedurën e prokurimit “*E hapur, Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara*”, me Nr. REF-66184-04-14-2023, me objekt: “*Shërbim akomodim personeli*”, me fond limit 39.592.000 lekë pa TVSH, zhvilluar më datë 18.05.2023 nga autoriteti kontraktor, Spitali Rajonal Memorial Fier.
2. Të pranojë ankesën e paraqitur nga operatorit ekonomik “*Eral*” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit.
3. Autoriteti kontraktor të anulojë procedurën e mësipërme të prokurimit dhe me rihapjen e procedurës të ketë parasysh konstatimet e mësipërme të bëra nga Komisioni i Prokurimit Publik.
4. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve, të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

5. Autoriteti kontraktor, brenda 5 ditëve të vërë në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.
  6. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “Haxhi Shahu” PF dhe nga operatori ekonomik “Eral” SHPK.
  7. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
  8. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar**  
**Fiorent Zguro**

**Anëtar**  
**Kreshnik Ternova**

**Kryetar**  
**Jonaid Myzyri**